



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

Nr. 4230 Prot.

Tiranë, më 05.11.2009

**V E N D I M**

**Nr.1016, datë 28 .10.2009**

**Mbi**

**“Shqyrtimin e praktikës së aplikimit të subjektit “Mobile Broadband Network Albania” sh.p.k per pajisje me autorizim individual per perdorimin e brezit te frekuencave 1785-1805 MHz”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- |                      |         |
|----------------------|---------|
| 1. Z. Ilir Shehu     | Kryetar |
| 2. Z. Afrim Tonuzi   | Anëtar  |
| 3. Znj. Edlira Kasaj | Anëtar  |
| 4. Z. Ilir Zela      | Anëtar  |
| 5. Z. Jetmir Karini  | Anëtar  |

në mbledhjen e datës 28. 10. 2009, nën drejtimin e anetarit të KD-se Z. Afrim Tonuzi sipas nenit 18 të Rregullores së Brendshme, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 7 e në vijim të Rregullores së Brendshme, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar, morri në shqyrtim praktiken mbi aplikimin e subjektit “Mobile Broadband Network Albania” sh.p.k per pajisje me autorizim individual per perdorimin e brezit te frekuencave 1785-1805 MHz

**BAZA LIGJORE:**

1. Shkronjat ë), g), gj) të nenit 8, Kreu VII, pika 1, e nenit 114 të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Pika 6, neni 3 i “Rregullore për Autorizim Individual”- per caktim dhe perdorim te frekuencave (*Rregullorja e Autorizmit Individual* ), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (VKD) të AKEP, Nr. 510, datë 04. 11. 2008.

Nga shqyrtimi i:

- a) Trajtimin të aplikimeve dhe të gjithë korespondencës në lidhje me aplikimin e “Mobile Broadband Network Albania” (MBNA) sh.p.k per pajisje me autorizim individual per perdorimin e brezit te frekuencave 1785-1805 MHz;

- b) Relacionit te Drejtorise se Rregullimit Teknik te AKEP nr.3182, date 04.08.2009 mbi praktikat me brezin e frekuencave 1785-1805 MHz, te kerkuar ne mbledhjen e Keshillit Drejtues te dates 29.07.2009;
- c) Rezultateve te takimit te Keshillit Drejtues me subjektin “Mobile Broadband Network Albania” sh.p.k

### V Ë R E H E T se :

1. Me date 22.11.2008 subjekti “Mobile Broadband Network Albania” sh.p.k kerkon pajisjen me autorizim individual per perdorimin e frekuencave te brezit 1785-1805 MHz (pasi eshte regjistruar ne regjistrin e sipermarresve).

Me shkresen nr.3258/3 prot., date 17.12.2008 të Drejtorit Ekzekutiv, subjektit MBNA i behet konfirmimi i njoftimit sipas rregjimit te Autorizimit te Pergjithshem, ndersa kerkesa per pajisje me Autorizim Individual i refuzohet per shkak te parregullsive ne kerkesen si dhe me arsyetimin se PKRF eshte ne proces rishikimi.

Me date 26.12.2008, me shkresen nr. 3258/4 prot (prot AKEP), subjekti MBNA kerkon shpjegime lidhur me trajtimin qe i eshte bere kerkeses per pajisje me Autorizim Individual.

Ne pergjigje te shkreses te dates 26.12.2008, me date 13.01.2009 Drejtori Ekzekutiv ben me dije MBNA se AKEP shqyrtoi me pergjegjesi pretendimet dhe njofton se MBNA nuk mund te pajisjet me Autorizim Individual per perdorimin e frekuencave te brezit (1785-1805 MHz) dhe per frekuenca te brezit 8 deri 13 GHz, per lidhje fikse radio.

Me date 20.01.2009, subjekti MBNA i drejtohet me nje ankese Ministrise se Puneve Publike Transporit dhe Telekomunikacioneve. Ne pergjigjen e MPPTT-se ne shkresen nr.454/1, date 05.02.2009, pergjigje qe i behet me dije dhe AKEP, citohet: *“Ne planin kombetar te radio frekeuncave (VKM nr. 379, date 31.05.2001, i ndryshuar) brezi 1,785 Ghz-1805 Ghz, eshte i ndare ne dy nenbreza*

- *1.785-1.800 Ghz, per perdorim CIVIL dhe QEVERITAR.*
- *1.800-1.805 Ghz per perdorim CIVIL*

*Bazuar ne keto percaktime, kompanise suaj nuk mund t'i jepet ne perdorim ekskluziv brezi 1.785Ghz-1.800Ghz ku jane parashikuar edhe perdorues QEVERITARE.*

*Sa me siper, Kompania juaj mund te aplikojte per Autorizim Individual ne AKEP, ne brezin 1.800 Ghz-1.805Ghz”*

Me shkresen nr.3226 prot., date 13.05.2009, MPPTT kerkon pajisjen me Autorizim Individual te MBNA-se.

Me date 18.05.2009, Drejtori Ekzekutiv i pergjigjet MPPTT-se ku sqaron se ka marre takime me subjektin dhe e ka bere me dije qe aplikimi te jete per brezin 1800 MHz-1805 MHz dhe jo per te gjithë brezin, si dhe ben te ditur: *“se nderkohe AKEP-i ka administruar edhe nje kerkese tjeter per brezin 1785MHz-1805MHz nga kompani “MOBIK” dhe materialet perkatese i kane kaluar Keshillit Drejtues te AKEP per vendim sipas nenit 68 te Ligjit Nr.9918 “Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise”.*

Ne vijim te komunikimit me MPPTT, Drejtori Ekzekutiv adreson edhe nje tjetër pergjigje me date 01.06.2009 me pothuajse te njejten permbajtje.

Me date 06.05.2009, me VKM nr.479 eshte miratuar plani kombetar i radio frekuncave ku percaktimet per brezin ne fjale kane ndryshuar.

Me shkresen nr.3226/4 prot., date 17.06.2009, MPPTT kerkon nisjen e keshillimit publik me palet e interesuara per perdorimin e brezit te frekuencave 1800-1805MHz.

Ne mbledhjen e tij te dates 29.07.2009, sipas proces verbalit te mbledhjes me nr. 2953 prot., date 30.07.2009, Keshilli Drejtues i kerkon Drejtorise se Rregullimit Teknik te pergatise nje relacion ne lidhje me trajtimin e kerkesave per pajisjen me autorizim individual te subjekteve per frekuencat ne brezin 1785-1805 MHz.

Me date 04.08.2009, nr. 3182 prot. Drejtoria e Rregullimit Teknik i drejtohet Drejtorit te Kabinetit me relacionin mbi praktikaten me brezin e frekuencave 1785-1805 MHz.

Me shkresen nr.3391, prot (AKEP), date 31.08.2009, drejtuar Keshillit Drejtues te AKEP, MBNA kerkon organizimin e nje takimi per ndricimin dhe transparencen e trajtimit te kerkeses se subjektit, duke pretenduar qe: *“Pergjigjet e kthjera, qe mbajne firmen e Drejtorit Ekzekutiv, z. Ilir Shehu ne lidhje me kete ceshtje, pasi i kemi analizuar me vemendje, na rezultojne te pabazuara ne ligj dhe ne rregulloren perkatese”*.

Me date 18.09.2009, ne takimin e organizuar midis Keshillit Drejtues te AKEP dhe MBNA, pasi u degjuan pretendimet e subjektit Keshilli Drejtues u shpreh se nevojitet kryerja e nje shqyrtimi te brendshem dhe se subjekti do te njihet me perfundimet e ketij shqyrtimi si dhe me ecurine e metejshme.

2. Per brezin e frekuencave 1785-1805MHz, kane shprehur interes dy subjekte per pajisje me Autorizim Individual per perdorimin e brezit: “Mobile Broadband Network Albania” sh.p.k dhe “Mobik” sh.p.k. dhe ne baze te nenit 68 te ligjit 9918, per te siguruar perdorim eficient te tyre, AKEP kryen nje proces keshillimi publik me palet e interesuara per kushtet e perdorimit te ketij brezi.
3. Ne planin kombetar te frekuencave miratuar me VKM nr.479, date 06.05.2009, eshte percaktuar se brezi 1785-1800MHz eshte per perdorim CIVIL dhe QEVERITAR.
4. Nga shqyrtimi i te gjithe praktiketes si dhe nga pretendimet e paraqitura nga vete subjekti ne takim me KD, rezulton se kjo kerkesa nuk eshte sjelle ne vemendje te KD-se brenda afateve ligjore dhe se refuzimi i aplikimit per pajisje me Autorizim Individual te subjektit “Mobile Broadband Network Albania” sh.p.k eshte bere ne kundërshtim me “Rregullore për Autorizim Individual”- per caktim dhe perdorim te frekuencave, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, Nr. 510, datë 04. 11. 2008.  
Refuzimi i kerkeses per pajisje me Autorizimin Individual per perdorimin e frekuencave eshte bere nga ana e Drejtorit Ekzekutiv te AKEP, ne shkelje flagrante te ligjit dhe ne tejkallim te plote te kompetencave qe i ngarkon detyra.

## **PER KETO ARSYE:**

Këshilli Drejtues i AKEP-it, në mbështetje të pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 115, pikes 1 te nenit 68, të ligjit nr. 9918, si dhe pikes 6 neni 3 te “Rregullore te Autorizimit Individual”, per te siguruar perdorim eficient te frekuencave.

## **VENDOSI:**

1. Te konsideroje te gabuar proceduren e trajtimit dhe refuzimit te kerkeses per pajisje me Autorizim Individual te subjektit “Mobile Broadband Network Albania” sh.p.k per brezin e frekuencave 1785-1805 MHz, dhe ne tejkalim te kompetencave qe i ngarkon ligji, nga ana e Drejtorit Ekzekutiv Z. Ilir Shehu.
2. Të kerkoje pergatitjen e dokumentacionit per kryerjen e nje keshillimi publik me palet e interesuara per kushtet e perdorimit te brezit te frekuencave 1800-1805MHz.
3. Kthimi i pergjigjes se kerkeses se subjektit “Mobile Broadband Network Albania” sh.p.k per perdorimin e brezit te frekuencave 1785-1805 MHz, te jete sipas Lidhjes 1, bashkengjitur.
4. Vendimi t’i behet i ditur Kryetares se Kuvendit të Shqipërisë, Kryeministrit dhe Ministrit te Shtetit dhe Reformat dhe Marredheniet me Kuvendin.
5. Te ngarkoje anetarin e Keshillit Drejtues Z. Afrim Tonuzi per njoftimin e ketij vendimi, ne cilesin e kryetarit zevendesues te KD-se.
6. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

**KRYETAR I KESHILLIT DREJTUES**

**Ilir SHEHU**

**Anëtarët e Këshillit Drejtues**

**Afrim TONUZI** \_\_\_\_\_

**Edlira KASAJ** \_\_\_\_\_

**Ilir ZELA** \_\_\_\_\_

**Jetmir KARINI** \_\_\_\_\_



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tirane, me \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2009

**Lenda:** *Kthim pergjigje*

**Sipermarresit: “Mobile Broadband Network Albania” sh.p.k**  
Rruga “Ali Visha”, Pallati 2, Shkalla 2, Ap.11

**Tirane**

Ne pergjigje te kerkeses tuaj per pajisje me autorizim individual per perdorimin e brezit te frekuencave 1785-1805 MHz, Ju sqarojme si me poshte vijon:

Ne mbledhjen e tij te dates 28.10.2009, Keshilli Drejtues i Autoritetit te Komunikimeve Elektronike dhe Postare morri ne shqyrtim praktiken mbi aplikimin tuaj per perdorimin e ketij brezi dhe doli ne perfundimin se refuzimi i kerkeses per pajisje me Autorizimin Individual per perdorimin e frekuencave ne brezin 1785-1805 MHz eshte bere nga ana e Drejtorit Ekzekutiv te AKEP ne kundershtim me “Rregullore për Autorizim Individual”- per caktim dhe perdorim te frekuencave, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, Nr. 510, datë 04. 11. 2008, dhe ne tejkalim te kompetencave qe i ngarkon ligji.

Pavaresisht sa me sipër, AKEP mendon se interesi per kete brez frekuencash eshte me i madh se frekuencat e mundshme per caktim dhe ne baze te nenit 68, pika te Ligjit Nr. 9918, date 19.05.2008 “Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise”, si dhe percaktimeve te planit kombetar te frekuencave te miratuar me VKM nr.479, date 06.05.2009, per te siguruar perdorim eficient te ketyre frekuencave, vendosi te kerkoje pergatitjen e dokumentacionit te nevojshem per kryerjen e nje keshillimi publik me palet e interesuara per kushtet e perdorimit te brezit te frekuencave 1800-1805MHz.

Me perfundimin e keshillimit publik, AKEP do te trajtoje dhenien ne perdorim te ketij brezi te frekuencave ne baze te procedurave qe do te vendosen nga rezultatet e keshillimit publik.

Bashkengjitur do te gjeni VKD te AKEP nr.1016, date 28.10.2009.

Duke Ju falenderuar per mirekuptimin AKEP, garanton se do te trajtoje me transparence dhe pergjegjesi te gjitha aplikimet qe do te adresohen per marrjen ne perdorim te ketij brezi frekuencash ne baze te procedurave qe do te vendosen nga rezultatet e keshillimit publik.

**P/KRYETAR I KESHILLIT DREJTUES**

**Afrim TONUZI**